



## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1611/3 Prot.

Tiranë, më 09 / 12 / 2020

### V E N D I M

Nr. 177, Datë 09 / 12 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 138, datë 25.11.2020, të paraqitur nga V. V, kundër Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), në të cilën pretendohet diskriminim për “çdo shkak tjetër”<sup>2</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues parashtron se është diskriminuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH), pasi është larguar pa të drejtë nga puna. Ankuesja citon se ka qenë e punësuar pranë këtij Insiticioni nga data 17.05.2019-05.10.2020. Për periudhën nga data 17.05.2019-16.10.2019 ka ushtruar detyrën e Drejtores së Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme (DSHB) dhe për periudhën nga data 16.10.2019-05.10.2020 ka ushtruar detyrën e Përgjegjëses së Sektorit të PPP, në varësi administrative të Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes.

Nëpërmjet shkresës me nr. 443/2 prot., datë 02.10.2020 të ARRSH “Urdhër i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe financiare”, i është komunikuar ndërprerja e marrëdhënieve të

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Pa përcaktuar një cilësi apo shkak.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

punës, me motivacionin *“Punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë si dhe me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit”*. Masa e largimit nga puna për ankuesen është marrë bazuar në opinionin ligjor të Drejtorit Jurik, V.H, mbi angazhimet e auditimit të brendshëm të datës 01.10.2020.

Subjekti ankues, ka shpjeguar rrethanat e marrjes së kësaj mase disiplinore, me të cilën është njohur po nëpërmjet shkresës me nr. 443/2 prot., datë 02.10.2020, duke parashtruar se:

Për periudhën nga data 17.05.2019-16.10.2019 ka ushtruar detyrën e Drejtores së DSHB dhe kjo drejtori përfshinet tre sektorë:

- Sektorin e Burimeve Njerëzore;
- Sektorin e Shërbimeve;
- Sektorin e Arkivës dhe Protokollit.

Ankuesja shprehet se, Titullari aktual i ARRSH, E.V, gjatë periudhës kur ankuesja ushtronte detyrën e Drejtores së DSHB, ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes (DNM), dhe njëkohësisht ka qenë në pozicionin e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH.

Me largimin nga detyra të drejtueses së atëhershme S.Q, nëpërmjet Urdhrit nr. 360, datë 04.10.2019 të Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, E.V, u autorizua për të ushtruar kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH.

Në datën 16.10.2019, menjëherë pas marrjes së detyrës nga E.V, ankuesja shprehet se është liruar nga detyra e Drejtores së DSHB, pa asnjë motivacion dhe është zëvendësuar nga G.G, i cili ishte i shkarkuar më parë nga detyra e tij si Drejtor i DSHB, nga Titullarja e mëparshme që në datën 25.02.2019 së bashku me një pjesë tjetër të ish-menaxherëve të ARRSH dhe ai ishte rikthyer në datën 16.10.2019 pa asnjë procedurë transparente.

Ankuesja pas lirimimit nga detyra e Drejtores së DSHB, me datë 16.10.2019 u emërua në detyrën e Përgjegjës së PPP deri me datë 05.10.2020, kur u lirua përfundimisht nga detyra.

Ankuesja shprehet se nga ana e Drejtorit aktual të DSHB janë rekrutuar dy punonjëse në Sektorin e Auditit të Brendshëm të ARRSH në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 *“Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”* si dhe Rregulloren e Brendshme të ARRSH: M.S me detyrë Përgjegjëse Sektori e Auditit të Brendshëm dhe M.J, Specialiste pranë këtij Sektori, e cila përpara kësaj detyre mbante pozicionin e Përgjegjës së Sektorit të DSHB, dhe kishte qenë vartëse e ankueses dhe e shkarkuar nga detyra me propozimin e saj dhe autorizim të ish-Titullares së mëparshme.

Ankuesja është shprehur se është njohur me konkluzionet e Raportit të Auditit të Brendshëm me datë 05.10.2020, nëpërmjet shkresës me nr. 443/2 prot., datë 02.10.2020. Në këtë datë ankuesja është njohur me *“Përfundimet e Angazhimit të Auditimit të Brendshëm të veprimtarisë së*

DSHB”, në bazë të programit të auditimit, nëpërmjet shkresës me nr. 9804 prot., datë 24.10.2019 “Programi i Angazhimit të Auditimit në DSHB pranë ARRSH-së”, për periudhën prej datës 01.01.2019-01.10.2019.

Subjekti ankues ka pretenduar se e gjithë procedura e këtij angazhimi është diskriminuese ndaj saj, duke parashtruar shkeljet e këtij auditimi. Kështu, ankuesja ka parashtruar se:

Së pari, DSHB nuk ishte audituar asnjëherë më parë nga Sektori i Auditit të Brendshëm për vitet 2017, 2018 dhe nuk ka asnjë raport auditimi për këtë Drejtori apo Sektorë të veçantë të saj. Ky auditim filloi me datë 04.11.2019 deri me datë 30.11.2019.

Nëpërmjet shkresës me nr. 9804/1 prot., datë 11.12.2019 është dërguar Projekt-raporti i angazhimit të Auditimit të hartuar nga Sektori i Auditimit të Brendshëm të ARRSH.

Me shkresën me nr. 9804/23 prot., datë 23.12.2019 ankuesja ka dërguar observacionet lidhur me gjetjet e këtij Projekt-raporti.

Me shkresën me nr. 9804/26 prot., datë 31.12.2019 është dërguar Raporti Përfundimatr i angazhimit të Auditimit pranë DSHB, sipas të cilit kërkohet të konfirmohet zyrtarisht plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna brenda periudhës kohore 30 ditore.

Ndërsa njoftimi i planit të rekomandimeve u krye nëpërmjet shkresës me nr. 443/2 prot., datë 02.10.2020 nga Drejtori i përgjithshëm, rreth 9 muaj me vonesë.

Ankuesja citon se, gjatë gjithë kësaj periudhe nuk është informuar asnjëherë, lidhur arsyen e vonesës së njoftimit të planit të masave apo me arsyen e shtyerjes së afatit të njoftimit të masave, duke pretenduar se e gjithë kjo procedurë është abuzive dhe diskriminuese.

Së dyti, ankuesja megjithëse shprehet se pavarësisht faktit se Grupi i Auditimit të brendshëm përbëhet nga: M.S, në cilësinë e përgjegjëses së grupit dhe R.K në cilësinë e anëtarit të këtij grupi, kjo nuk përjashtonte mundësinë e angazhimit në auditim të punonjësës M.J, e cila ishte shkarkuar nga detyra me propozimin e saj si ish-Drejtores e DSHB.

Ankuesja shprehet se kjo gjë mund të përbente shkak për konflikt interesi në rastin e saj dhe pretendon se Drejtori i DSHB, G.G, ka emëruar këtë punonjëse në këtë pozicion pikërisht për t’u hakmarrë ndaj asaj meqenëse kishte propozuar largimin e tij nga detyra.

Ankuesja ka pretenduar si një ndër parregullsitë e auditimit në fjalë, faktin që ky auditim ishte bërë në mënyrë selektive dhe jo gjithëpërfshirëse, duke bërë që ajo të mendonte se ai ishte një audit personal dhe jo për DSHB në tërësi, pasi kishte lënë jashtë fokusit të tij dy sektorët e tjerë të kësaj Drejtorie, atë të Shërbimeve të Brendshme (i cili atëherë drejtohej nga Specialistja e Auditit M.J) dhe atë të Arkivës e Protokollit. Në këtë kontekst, ankuesja ka pretenduar për njëanshmëri të këtij auditimi, pasi ajo pretendon se në të janë përfshirë vetëm personi i saj, E.G dhe vartësja e saj T.L. Nga ana tjetër, ankuesja shprehet se raporti i këtij auditimi nuk ka

argumetuar lidhur me faktin se përse janë përjashtuar nga auditimi planet e shërbimeve të DNM dhe sektorëve në varësi të saj, pasi ARRSH ka mbi njëqind punonjës që janë angazhuar me plane shërbimi gjatë periudhës së audituar, dhe asnjë prej tyre nuk është audituar duke bërë që ajo të trajtohej në mënyrë diferencuese tendencioze.

Si shkelje dhe tendencë tjetër të Grupit të Auditimit ndaj saj, ankuesja ka cituar edhe angazhimin e këtij grupi për të sqaruar faktet dhe tendencat lidhur me masat disiplinore “Largim nga detyra” të ish-drejtnesve të lartë të ARRSH në muajin shkurt 2019, një ndër të cilët edhe Drejtori aktual i DSHB, G.G. Ankuesja shpjegon se gjatë gjithë periudhës së angazhimit të auditimit nuk është kontaktuar asnjëherë nga Grupi i Auditimit për të dhënë sqarimet e tyre lidhur me gjetjet e auditimit. Ankuesja shprehet se ky raport auditimi ka indicie kompromentuese dhe mungesë besueshmërie në të, duke cituar shkelje të tilla si:

- Mbështetja e gjetjeve të këtij grupi në urdhra verbal të Drejtorit të Përgjithshëm, përmendja e emrave të individëve, në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm të ARRSH.
- Shkresa nr. 1920 prot., datë 25.02.2019 është protokolluar në të njëjtën datë kur pretendohet se ish-Drejtori i përgjithshëm ka patur librin e protokollit në zyrë.
- Nuk ka të evidentuar një komunikim zyrtar të Grupit të Auditimit me personat që kanë mbajtur këtë proceverbale për sqarimin e rrethanave në të cilat është mbajtur ai.
- Nuk është marrë në konsideratë në Raportin e Auditimit observacioni i paraqitur nga ish-vartësja T.L, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore, lidhur me kontestimet pikërisht për procesverbalin e cituar.
- Grupi i Auditimit është shprehur se në të njëjtën datë janë larguar 13 punonjës nga Institucioni, duke i cituar respektivisht, por nuk ka cituar urdhrin e largimit nga detyra të Drejtorit aktual të DSHB, G.G dhe është shprehur se këta punonjës janë larguar në mënyrë të padrejtë, abuzive dhe tendencioze nga Institucioni.
- Grupi i Auditimit nuk ka reaguar lidhur me indiciet e dhëna nga ankuesja për shkeljet dhe shpërdorimin e detyrës lidhur me të ardhurat e përfituara padrejtësisht, pa plan pune për periudhën mars 2019.

Ankuesja shprehet se nëpërmjet shkresës me nr. 9804/23 prot., datë 23.12.2019 “Objeksione në lidhje me projekt raportin e angazhimit të auditimit të brendshëm” ndër të tjera, ka kërkuar shpjegime lidhur me emrat e 13 punonjësve të larguar dhe në të njëjtën kohë ka kërkuar shpjegime lidhur me faktin se përse asaj i është përmendur emri si person përgjegjës, pasi ajo në këtë periudhë nuk ka qenë në marrëdhënie pune me ARRSH. Këta punonjës janë larguar nga puna në muajin shkurt 2019, ndërkohë që ankuesja ka lidhur marrëdhëniet e punës me ARRSH në datën 17.05.2019 në detyrën e Drejtores së DSHB.

Ankuesja shprehet se këto fakte nuk janë marrë në konsideratë nga Grupi i Auditimit në Raportin përfundimtar të tij, duke bërë që konstatimet e tij të jenë të pabazuara, të padrejta dhe tendencioze ndaj saj me qëllim për t’a dëmtuar atë.

Nëpërmjet shkresës me nr. 443/1 prot., datë 01.10.2020 “Opinion ligjor mbi angazhimin e auditit të brendshëm”, Raporti përfundimtar i grupit të Auditimit, është pasuar nga opinioni ligjor i Drejtorit Juridik të ARRSH, për rekomandimet e të cilit ankuesja është shprehur se Institucioni ka zbatuar dy standarte të ndryshme. Ajo ka cituar se Drejtori Juridik dhe Përgjegjësja e Grupit të Auditit të Brendshëm të ARRSH kanë mashtruar, fallsifikuar dhe shpifur për ta larguar atë nga Institucioni, duke i mohuar dhe të drejtën për t’u njohur dhe për t’u mbrojtur efektivisht ndaj gjetjeve të tyre në shkresat me nr. 443/1 prot., datë 01.10.2020 dhe shkresën me nr. 443/2 prot., datë 02.10.2020.

Ankuesja citon se Drejtori Juridik dhe Përgjegjësja e Grupit të Auditimit kanë vepruar në kundërshtim flagrant me Kodin e e Punës dhe kanë abuzuar me detyrën, duke e diskriminuar atë, me qëllim largimin e saj nga puna. Nuk është sqaruar në asnjë moment në asnjërin nga raportet e këtyre dy punonjësve, as të Drejtorit Juridik, as të Grupit të Auditimit, fakti i përfshirjes së ankueses në procedurat e ndjekura për largimin e 13 punonjësve të ARRSH nga ish-Titullarja e këtij institucioni.

Ankuesja ka pretenduar se e gjithë procedura e auditimit të iniciuar dhe misioni i Grupit të Auditimit ka qenë për sqarimin e faktit se Drejtori aktual i DSHB, G.G ishte larguar në mënyrë të padrejtë nga ish-titullarja e ARRSH dhe se ai në momentin e rikthimit është hakmarrë në emrin e vet apo të miqve të tij të larguar. Znj.V pretendon se në këtë logjikë ai ka emëruar në mënyrë të paligjshme Përgjegjësen e Grupit të Auditimit M.S e cila i ka kthyer favorin e këtij emërimi, duke ndërmarrë një auditim krejtësisht në dëm të personit të saj duke e diskriminuar atë.

Nga ana tjetër, ankuesja është shprehur se me datë 10.03.2020 i është drejtuar Kryeministrit nëpërmjet një sms, duke denoncuar një ngjarje të pahijshme të ish-shoferit të titullarit të Institucionit, i cili komunikoi në grupin e whatsapp të ARRSH, një video porno. Në të njëjtën ditë Titullari i Institucionit ka reaguar duke kërkuar ndjesë për veprimin e shoferit, si dhe ka kërkuar dorëheqjen e tij. Në këtë kontekst, ankuesja ka pretenduar se Titullari i Institucionit ka vepruar duke e larguar atë nga puna, për t’u hakmarrë ndaj saj, si dhe për të marrë në mbrojtje ish kolegët e tij të mëparshëm, përmes një raporti auditimi krejtësisht diskriminues.

Ankuesja është shprehur se Titullari i Institucionit ishte në dijeni të faktit se ajo do të largohej vullnetarisht nga ARRSH për të vazhduar karrierën e saj diku tjetër, pasi kishte aplikuar për pozicione të tjera pune dhe për këtë gjë i kishte kërkuar vlerësimin e performancës së punës apo një letër reference në anglisht që më datë 19.08.2020. Në këtë logjikë, ajo citon se: “ *Edhe pse e dinin që do të largohesha nga Institucioni për të vazhduar karrierën time, veprimet e tyre të qëllimshme, hakmarrëse dhe diskriminuese vazhduan më tej dhe më dëmtuan karrierën time të suksesshme prej 22 vitesh, sikurse aplikimi im tek Komisioni i Kualifikimit të Pavarur u refuzua për shkak të masës disiplinore*”.

Ankuesja ka pretenduar për diskriminim të ARRSH ndaj ish-vartësës së saj, T.Z, në formën e shqetësimit.

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga KMD, të konstatojë qëndrimin diskriminues të ARRSH ndaj saj.

- Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.
- Për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it të datës 24.11.2020, Specialistja e Drejtorisë së Pritjes së Ankesave, pranë Zyrës së KMD, i ka kërkuar subjektit ankues të saktësojë dhe dokumentojë shkaqet e pretenduara “çdo shkak tjetër” dhe “përkatesinë në një grup të veçantë” dhe të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm.
- Sërish, nëpërmjet e-mailit të datës 25.11.2020 i është kërkuar ankueses të specifikojë dhe dokumentojë se cili është shkak i pretenduar/cilësia, karakteristika e saj personale mbi bazën e së cilës ajo pretendon se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë apo të padrejtë nga ARSSH.
- Nëpërmjet e-mailit të dërguar, ankuesja citon se: *“Referuar komunikimit tuaj, ju lutem gjeni bashkëngjitur e-mailin sqarues drejtuar Komisionerit në lidhje me shkakun e shqetësimit në referencë të Nenit 1, të LMD”*. E-maili i referuar prej saj, është ai i datës 24.11.2020, ku subjekti ankues ka specifikuar se pretendon diskriminim “për çdo shkak tjetër”, pa dhënë ndonjë specifikim lidhur me të.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatesinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatesinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur*

*të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument, indicie apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë shkakut specifik, duke mos arritur të identifikojë se cili është ky shkak, apo e ndonjë karakteristike të mbrojtur, sipas parashikimeve të nenit 1 të LMD-së.

Referuar përmbajtjes së nenit 1 të ligjit nr. 10221/2010, rezulton tepër e qartë dhe evidente, që të gjitha shkaqet e përmendura, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësi, apo karakteristika individuale të personave që pretendojnë për diskriminim. Situata diskriminuese në vetvehte është gjithmonë e lidhur me një veçori individuale të viktimës dhe në rastin konkret, subjekti ankues nuk ka identifikuar një shkak të vlefshëm diskriminimi, që të ketë lidhje me një nga karakteristikat personale të përcaktuara në LMD.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ndërsa, përsa i përket pretendimit të ankueses për sjellje diskriminuese të ARRSH ndaj punonjëses T.Z, ish-vartëse e saj; Komisioneri vlerëson se ajo nuk legjitimohet si përfaqësuese ligjore e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues V. V, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Punësim  
Shkaku: Çdo shkak tjetër  
Lloji i vendimit: Mospranim